



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-07/IA002

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 janar 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësve të Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

Karl Bakli

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullave 58, 169 dhe 170 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelin e ndërmjetëm të z. Nasim Haradinaj ndaj vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për mbajtjen e tij në paraburgim (“Apeli”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 shtator 2020, z. Haradinaj u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 24 shtator 2020² dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 26 shtator 2020.³

2. Më 24 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Haradinaj dhe refuzoi kërkesën e tij për seancë gojore në lidhje me këtë çështje (“vendimi i kontestuar”).⁴

3. Më 5 janar 2021, z. Haradinaj apeloj vendimin e kontestuar.⁵

II. CAKTIMI

¹ F00001, Njoftim për apelim të ndërmjetëm në emër të Nasim Haradinajt të vendimit për mbajtje në paraburgim, 5 janar 2021.

² Shih F00012, Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, 24 shtator 2020.

³ Shih F00020, Njoftim për pranimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 shtator 2020.

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Kai Ambos

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për apelin.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 6 janar 2021
Në Hagë,
Holandë.

⁴ F00094, Vendim për rishikimin e paraburgimit të Nasim Haradinajt, 24 dhjetor, para. 51.

⁵ Shih në përgjithësi Apelin.